



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XI-të (njëmbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 31 maj 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:40.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, kurse mungoi znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, z.Fadil Babatinca përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Podujevë, znj.Maljeta Rama nga ZKKK, znj.Fitore Sejdiu nga komunitetet jo shumicë, z.Skender Shatri dhe z.Bekim Karaxhija nga OSBE.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, lexon pikat e rendit të ditës dhe pyet nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 28.04.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 28 prill 2023

2. Draft Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, materialin e keni marrë me kohë besoj dhe keni mundur ta lexoni dhe analizoni, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, përndryshe prezent këtu kemi edhe shefin e ZKKK në Podujevë, Zyrë e cila ka të bëjë me këtë çështje, andaj edhe mund t'ia japim fjalën.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, duke e paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me një draft plan i cili është hartuar dhe përgatitur në punime dhe trajnime të ndryshme qoftë brenda ashtu edhe jashtë vendit duke falënderuar Ministrinë e Mbrojtjes, Caritasin Zvicrran dhe të gjithë zyrtarët përkatës të nivelit qendrorë dhe ata të shërbimeve të ndryshme të nivelit lokal të përfshirë në përgatitjen e këtij dokumenti.

Drafti në fjalë është në fazën e diskutimit publik ku paraprakisht është shqyrtuar në mbledhjen e KPF-ës më 12.05.2023 dhe në Kuvendin e Komunës më 15.05.2023, prandaj kemi pasë diskutime të ndryshme publike dhe takime brenda për brenda Komunës deri te hartimi i këtij drafti i cili natyrisht se është hartuar dhe është i bazuar në linja të qëndrueshme të nivelit qendrorë e që akterët kryesor janë Ministria e Punëve të Brendshme e cila ka departamente përkatëse që merren me riintegrimin e personave të riatdhesuar por që tani është shtuar edhe fusha e azilkërkuesve apo të huaj që është një plan i veprimit në nivel nacional por që është i adaptuar në të gjitha komunat dhe që ka të bëjë me integrimin e të riatdhesuarve që ka qenë më parë dhe që tani është edhe për të huaj. Më 28 korrik 2010 është nënshkruar një memorandum Mirëkuptimi nga Shteti i Kosovës me akterë ndërkombëtarë sipas të cilit do të kthehen të gjithë shtetasit tonë që janë në shtetet tjera të ciklet nuk kanë mundur ta rregullojnë statusin e tyre ekonomik, politik, dhe shkaqe tjera, dhe në bazë të asaj Marrëveshje çdo herë kanë ardhur bashkëvendës tanë ku fillimisht kanë filluar me proceduar përkatëse ligjore në Aeroportin e Kosovës, pastaj kanë kaluar tek organet përgjegjëse që merren me çështjen e tyre siç është Ministria e Punëve të brendshme n' kuadër të të cilës janë disa Departamente për çështje të tilla dhe në fund janë Zyrat komunale për komunitete, dhe zyrat apo zyrtarët për integritime europiane në kuadër të komunave që merren me personat e riatdhesuar qoftë në strehim, akomodim, shëndetësi e të tjera, shërbime të cilat i marrin nga niveli komunal dhe orientohemi në qendrën/zyrën e punësimit si dhe ata persona varësisht nevojave drejtohen edhe në qendrën për punë sociale.

Në bazë të këtyre rrethanave Komuna e Podujevës është një komunë shumë stabile dhe i'u kemi dhënë ndihmë të gjithë atyre qytetarëve që kanë ardhur sipas procesit të riatdhesimit qoftë në informacione për plotësimin e dokumentacionit në aspektin e të drejtës së tyre për konkurrim apo vetëpunësim sepse ata marrin informacione që pasi të kthehen në Kosovë kanë të drejtë të konkurrojnë me disa projekte nga të cilat mund të përfitojnë edhe mjete financiare ose ta shtojnë biznesin e tyre për çka janë të përcaktuar dhe me vite të tëra i'u kemi ndihmuar në rregullimin e dokumentacionit e që normale që edhe certifikohen në Qendrën e aftësisimit profesional dhe pas kësaj kanë të drejtë të konkurrojnë përmes UNDP dhe Organizatave tjera ndërkombëtare në mënyrë që këta persona të ndihmohen në aspektin e stabilizimit ekonomik.

Siç e cekta në këtë draft plan janë përfshirë edhe të huajt, pra të huajt që vijnë në vendin tonë në bëjmë strehimin e tyre sepse është e paraparë me Rregullore përkatëse, Kushtetutë, me Strategjinë përkatëse që të gjithë ata njerëz që ikin prej konflikteve, luftërave apo forma tjera qofshin ato ekonomike ose politike e që vijnë në Kosovë kemi qendrën e azilit ku ata strehohen për një kohë të caktuar dhe pasi të merren disa procedura dhe verifikohen nga komisionet qendrore që janë në kuadër të Departamentit për integrimin e azilkërkuesve në MPB në linjë edhe me Organizata tjera

ndërkombëtare e po ashtu edhe vendore, e që merren në shqyrtim dhe mund të jenë azil i përhershëm ose azil i përkohshëm. Pasi ta fitojnë statusin e azilit të përkohshëm ata persona fitojnë akomodimin, strehimin, ushqimin dhe të tjera, por nuk kanë të drejtë edhe që të kërkojnë punë sepse janë në një azil të përkohshëm, ndërsa ata persona që janë me azil të përhershëm kanë tjera përfitime siç janë qasje në dokumentacione, mund ta përfitojnë edhe shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe pas kësaj kanë të drejta në tregun e punës, konkurrim të bizneseve dhe gjitha tjera e një jete normale sepse pastaj bëhet qytetarë i Republikës së Kosovës andaj ne i përkrahim dhe duhet t'i përkrahim këto çështje dhe rrethana.

Sigurisht këto gjëra edhe i keni lexuar në dokumentin në fjalë dhe keni parë që janë të involvuara të gjitha organet përkatëse në këtë proces, duke filluar prej Ministrive të ndryshme, pastaj Qeverisja lokale – Drejtoritë dhe institucionet përkatëse lokale që merren me këtë çështje, në mënyrë që ne jemi të obliguar t'iu dalim në ndihmë atyre njerëzve dhe duhet t'i kryejmë detyrat tona që janë të përshkruara me rregulla ligjore.

Pra kjo që e paraqita është në pika të shkurtra por nëse ndokush ka interesim për ndonjë pyetje apo sqarim mund t'ju përgjigjem.

Kjo pikë dhe pika pasuese janë dy projekte që kalohen përmes Komitetit për Komunitete, Komitetit për Politikë dhe Financa, pastaj në Kuvendin e Komunës ku si drafte dalin në diskutim publik ku sigurisht për detaje keni mund të shihni në vendimet përkatëse, dhe pastaj si dokumente përfundimtare dalin sërish në këto Organe dhe miratohen si dokumente finale dhe mandej fillon zbatimi dhe veprimi i tyre.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri-shef i ZKKK për sqarimet dhe paraqitjen e këtij dokumenti. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë ju lus të deklaroheni me ngritje dore se a mbështetni këtë draft plan kështu siç është.

Njëzëri nga anëtarët e Komitetit për Komunitete mbështetet draft plani përkatës sipas materialit të dërguar, i cili pas përfundimit të të gjitha proceduarve do të sjellët sërish si dokument final për shqyrtim dhe miratim final në Kuvendin e Komunës.

3. Draft Plan i veprimit për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani kemi të bëjmë me draft planin për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës. Unë në cilësinë e Kryesuesit të këtij Komitete por edhe në cilësinë e përfaqësuesit të një pjese të Komuniteteve jo shumicë e falënderoj shumë shefin e ZKKK dhe të gjithë akterët tjerë që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti për të cilin mendoj se është mjaft i mirë për komunitetin jo shumicë RAE që jetojnë në Komunën e Podujevës e që besoj se pas miratimit final nuk do të jetë vetëm në letër por do të realizohet sepse janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar të gjitha fushat që janë të nevojshme për komunitetet jo shumicë siç janë Arsimi, Shëndetësia, Punësimi, Infrastruktura dhe të tjera, kështu që këtë draft e keni marrë me kohë dhe sigurisht keni pas kohë ta shfletoni dhe nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë para se ta përfundojmë mund t'ia japim fjalën edhe njëherë shefit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Podujevës sepse edhe kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me këtë zyrë.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, po ashtu duke paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, edhe ky plan është vazhdimësi e planeve tona si Komunë që nga viti 2016 me përjashtim të një pauze kohore kur kanë qenë masat specifike për shkak të pandemisë Covid-19.

Dokumenti është hartuar dhe përgatitur duke u bazuar në Strategjitë që janë miratuar për këtë çështje duke i falënderuar edhe Ministrinë përgjegjëse që merren me këtë çështje (Ministria e Pushtetit Lokal, dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim) si dhe është edhe Zyra për qeverisje të mirë pran Zyrës së Kryeministrit, e cila merret me integrimin e Komuniteteve jo shumicë.

Në bazë të këtij relacioni, ne e kemi marrë për bazë Strategjinë nacionale 2022-2026 për integrimin e Komuniteteve jo shumicë RAE si dhe një plan i veprimit që pjesë e kësaj Strategjie, por që edhe komunat është dashtë ta hartojnë dhe miratojnë planin komunal të veprimit i cili në bazë të një udhëzimi Administrativ që na është sjellë nga Ministria e Pushtetit Lokal, ne menjëherë kemi ndërmarrë veprime dhe kemi themeluar komisionin përkatës i cili përfshihet nga të gjithë akterët kryesor që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe hartimin e këtij Plani.

Në kuadër të këtij plani është e paraparë që Drejtorinë përgjegjëse të kenë qasje dhe të merren me këto çështje. Në përbërjen e këtij komisioni komunal veprues i cili është themeluar më 28.02.2023, koordinator apo kryesues është Drejtori i DKA-së z.Avni Fetahu, pastaj znj.Makfire Zeka dhe z.Halit Vërshefci nga DSHMS, unë si shëf i ZKKK, z.Ahmet Ahmeti dhe znj.Naime Podvorica nga Njësia për të drejtat e njeriut, znj.Haxhere Ajvazi nga DBF-Thesari i Komunës, pastaj është e paraparë që të jenë edhe 2 Organizata joqeveritare për të cilat ka qenë konkurs i hapur që të jenë 2 nga jashtë komunës dhe 2 Organizata brenda komunës, dhe megjithëse konkurse ka qenë i përsëritur dy herë për rreth 1 muaj nuk kanë konkurruar asnjë organizatë nga jashtë komunës, kurse kemi 2 organizata që veprojnë në territorin e Komunës së Podujevës, me theks për komunitetet jo shumicë që është OJQ “Qëndrimi” që është z.Xhafer Ademi i cili është kryetar i kësaj OJQ-je edhe Kryesues i këtij Komitete për Komunitete si dhe z.Fitim Sejdiu i cili vie nga komunitete Ashkali dhe është kryetar i OJQ “Një hap me ne”.

Në bazë të takimeve pune që kemi mbajtur, për çka falënderoj edhe OSBE-në për ndihmën në formimin e këtij komisioni, dhe në takimet e mbajtura kemi debatuar dhe i kemi analizuar Strategjitë dhe dokumentet tjera të nivelit qendrorë si kemi debatuar edhe praktika tjera të komunave tjera, e kemi përgatitur këtë dokument i cili fillimisht është draft dhe paraprakisht ka kaluar përmes KPF-ës dhe Kuvendit dhe tani është në fazën e diskutimit publik.

Shtyllat apo fushat kryesore në këtë draft janë Arsimit, Shëndetësia, Punësimi, Mirëqenia Sociale, Banimi, Infrastruktura, Mediat, Kultura, Rinia, Sporti, dhe Diskriminimi, dhe nëse ju pajtoheni unë mund t’ju flas për secilën fushë, mirëpo në pika të shkurtra mund t’ju them se ne kemi marrë të gjitha këto fusha dhe në bashkëpunim me të gjitha Drejtorinë komunale pothuajse si dhe me Komisionin komunal veprues, i kemi analizuar i kemi përgatitur dhe në fund kemi hartuar këtë draft plan si dhe kemi edhe planin zbatues i cili përcakton afate kohore dhe çështje tjera rreth zbatimit të këtij dokumenti në praktikë.

Në këtë draft mund të sugjerohen edhe ide, propozime, rekomandime dhe komente tjera, mirëpo kjo mund të bëhet edhe në rrugëtim të këtij plani sepse kemi të bëjmë me vitet 2023-2026 ku edhe mund të ndryshohet pavarësisht këtij që është tani. Gjithashtu pas miratimit të këtij dokumenti duhet të formohet edhe një komision për monitorimin e zbatimit të tij e që pastaj normale që do të ketë takime të ndryshme në aspektin se sa po zbatohet në praktikë.

Unë mendoj se në Komunën e Podujevës sa i përket Arsimit, infrastruktura në arsim është e rregulluar dhe të gjithë fëmijët e komuniteteve jo shumicë vijnë në mësimet dhe shkollimin bashkërisht me bashkëmohatarët e tyre nëpër shkolla, janë mirë të akomoduar dhe i kanë të gjitha kushtet normale e që nuk ka ndonjë problem përveç asaj që e kam cekë disa herë që ne duhet të

mendojmë për të ardhmen e fëmijëve dhe t'iu ndihmojmë edhe në sigurimin e ndonjë burse tjetër në ndonjë Organizatë tjetër qoftë ndërkombëtare qoftë vendore qoftë edhe me buxhetin komunal, dhe kjo për shkak që siç dihet jetojnë një gjendje paksa të rëndë ekonomike, andaj duhet të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për një stabilitet më të mirë në mënyrë që të mos vihet deri tek braktisja e shkollimit. Në këtë aspekt mund të them se në ciklin e ulët mësimor pjesëmarrja e nxënësve të komunitetit jo shumicë është e kënaqshme, po ashtu edhe në shkollat e mesme të larta edhe pse numri mund të jetë edhe më i lartë por që për shkak se në këtë nivel kanë të drejtë të gjithë ta gëzojnë bursën komunale por që unë vazhdimisht kamë ndihmuar ata në plotësimin e dokumentacioneve edhe për aplikime në Organizata ndërkombëtare dhe vendore për fitime të bursave siç është OJQ “Zëri i Romëve, Ashakilve dhe Egjiptasve” dhe në bashkëpunim me ë gjithë kemi arritur që t'iu ndihmojmë atyre në këtë kuptim, mirëpo në studime janë një numër shumë i vogël i studentëve nga komunitetet jo shumicë, andaj në këtë aspekt shqetësimet tona janë që t'iu ndihmojmë me ato mundësi që kemi dhe të kërkojmë ndihma për ata nxënës që dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

Unë kam shprehë falënderime që shumë nxënës të komuniteteve jo shumicë në shumë shkolla, duke falënderuar edhe Kryetarin e Komunës për lidhjen e Marrëveshjes me Organizatën IOM, të sigurojmë kabinete të ndryshme në ato shkolla ku ka edhe nxënës të komuniteteve shumicë siç janë shkollat e Podujevës “DR Ibrahim Rugova”, “Shaban Shala”, “Naim Frashëri”, pastaj “Luigj Gurakuqi”-Batllavë, dhe tani pritët edhe në shkollat e fshatrave Orllan dhe Sfeçël që të pajisen me kabinete të cilat kooptohet se Komuna merre pjesë me 30% të vlerës në ato kabinete kurse pjesën tjetër Bashkësia Europiane si bartëse e buxhetit ndërsa implementimin e projekteve e bënë Organizata IOM.

Shëndetësia ka një shkrirje të kënaqshme për të gjithë qytetarët dhe normale që dihet se në Komunën tonë të gjitha shërbimet shëndetësore jepen pa asnjë dallim dhe kjo duke falënderuar stafin shëndetësor por edhe vetëdijen dhe qytetërimin tonë ku për shërbime shëndetësore ka një shtrirje të madhe të qendrave shëndetësore (QKMF, QMF, AMF) që japin shërbime për të gjithë pa dallim në të gjitha fushat të ndryshme shëndetësore që ofrohen në Komunën e Podujevës, përveç çështjes tjetër ekonomike - sociale e cila është paksa më e ndjeshme e që është një numër më i madh i familjeve të Komuniteteve jo shumicë që është në asistencë sociale për shkak të çështjeve ekonomike për të cilën pothuajse jemi në dijeni si dhe çështja tjetër është punësimi si fushë pak më problematike dhe më e ndjeshme për çka po shohim se ka një trend tjetër për dallim nga e kaluara ku tani pothuajse po kalohet në kompani dhe biznese private andaj ne duhet të mendojmë se duhet të përgatitemi që të gjejmë forma dhe t'i përgatitemi komunitetet jo shumicë në mënyrë që ata të jenë të gatshëm për tu punësuar dh të gjejnë forma të ndryshme të punësimit qoftë edhe në kompani dhe biznese të ndryshme private. IOM ka ndihmuar shumë familje të komuniteteve jo shumicë të cilat kanë biznese dhe prona, për vetë punësim me mjete financiare dhe atë me vlera nga 4000.00€ - 5000.00€ e që janë më shumë se 10 familje për çka e falënderojmë Organizatën IOM për përkushtimin e tyre për ndihmën e dhënë në mënyrë që ato familje apo ata perona të kenë mundës që në të ardhmen të zgjerohen me vetëpunësim më të lehtë dhe të krijojnë edhe vende të reja të punës. Pra kjo ishte në pika të shkurtra në kuptimin e fushës së vetëpunësimit.

Çështja e banimit dhe strehimit është një çështje pak më e ndjeshme. Në muajin prill kam vizituar çdo familje në çdo lagje ku jetojnë komuniteti jo shumicë në bashkëpunim edhe me koordinatoren për të drejtat e njeriut dhe zyrtarin për të drejtat e fëmijëve, dhe në bazë të atyre analizave dhe raportit të punës që e kemi përgatitur së bashku me dosjet përkatëse të cilën i'a kemi paraqitur Kryetarin të Komunës drejtpërdrejt, shqetësimet kanë qenë, përveç fushave që i ceka, tek banimi dhe strehimi si dhe ndërtimi dhe renovimi i shtëpive të familjeve të komuniteteve jo shumicë e që

shumica absolute që kam parë në terren kanë pas kërkesa për renovim të shtëpive mbi 90% e tyre, mirëpo ka edhe një pjesë prej tyre që kanë hapësira apo pronë të legale të tyre për ndërtim dhe në kuadër të këtyre ne kemi komunikuar edhe Ministrinë e Linjës siç është Ministria për Komunitete dhe Kthim në të cilën më parë ka qenë një konkurs i hapur për aplikim dhe vazhdon të jetë e që sa jam në dijeni kanë konkurruar mbi 90 familje për renovim të shtëpive dhe 6 të tjerë për ndërtim të shtëpive nga Ministria e Pushtetit Lokal. Ne Komuna e Podujevës i'u kemi ndihmuar në rregullimin e dokumentacionit por që problemi i shumicës prej tyre ka qenë problemi pronësor, çështje kjo e cila do të jetë sfidë e jona edhe për të ardhmen e që mendojmë se bashkërisht do t'ia dalim dhe do të punojmë.

Infrastruktura është e rregulluar por ka edhe disa kërkesa të cilat besoj se do të rregullohen në të ardhmen. Ajo që është pak më shqetësuese dhe që e kam paraqitur si të tillë është rrejtja i ujësjellësit në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr. "Ali Ajeti" pra kërkohet një rrejtje e ri ku ne kemi bërë paramasat dhe paralogaritë të cilat i kemi paraqitur në takimet tjera për të investuar në këtë projekt si dhe disa projekte jo aq të mëdha dhe me një kosto jo të lartë të cilat i kemi dërguar edhe në Zyrën për Qeverisje të Mirë që është në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila na ka dhënë një sinjal pozitiv.

Mediat, ne jemi në dijeni se në Kosovë kanë dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh dhe falë mediave dhe rrjeteve sociale informacioni sot përhapet shpejt si dhe secili në formën e tij mund të jep idetë dhe sugjerimet e veta, por sigurisht që mediat janë të pavarura dhe mund të paraqesin probleme, shqetësime dhe takime të ndryshme raportuese me publikun por edhe atyre të formave që merren me probleme të ndryshme dhe raportojnë çështjet e komuniteteve.

Sporti, jemi në dijeni se kjo fushë është e hapur dhe më shumë ka kaluar në çështje private por çdo i ri apo e re që ka talent mund të inkuadrohet sepse është derë e hapur për të gjithë ata që kanë talent në aktivitetet e tyre.

Në Kulturë, normal që Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në bazë të mundësive të saj ka dhënë ndihma, kryesisht në shënimin e disa festave ku një ndër to është 15 shkurti - dita e flamurit të komunitetit Ashkali, pastaj 8 prilli është dita e komunitetit Rom, dhe në bazë të kërkesave që vijnë ne në koordinim të përbashkët dhe varësisht mundësive buxhetore ju japim ndihmë.

Sa i përket çështjes së diskriminimit si një fenomen që kërkon diskutim në kuptimin e asaj që ne po vijmë duke u adaptuar dhe bazuar secili në komunat e tyre. Diskriminimi mund të jetë racor, ngjyre, religjioz, gjuhë, kushte socio ekonomike, grupeve politike, paragjykimëve të ndryshme etj, por megjithatë në kuadër të kësaj kjo çështje është e rregulluar edhe me Konventë Ndërkombëtare, mirëpo ne e kemi të rregulluar edhe me Kushtetutë që në Republikën e shtetit tonë të mos ketë diskriminim. Ne e kemi të caktuar me vendim edhe zyrtaren përkatëse e cila merret me çështjet eventuale të diskriminimit të të gjitha fushave. Në bazë të kësaj në trajtimin e kësaj çështje që kemi bërë si Komunë e Podujevës, unë e kam potencuar dhe vazhdoj ta potencoj se jemi një prej komunave më stabile në këtë aspekt, dhe jemi duke bashkëjetuar si bashkëqytetarë dhe jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallime, madje po të pyetsha unë do ta heqja edhe termin komunitet jo shumicë ngase ne flasim një gjuhë këtu në Komunën e Podujevës si dhe normale që si shoqëri jemi të inkuadruar për të gjitha interesat e përbashkëta në të gjitha sferat e jetës, prandaj në këtë aspekt unë shpesh herë e kam quajtur veprim pozitiv diskriminimin ngase diskriminimi shpeshherë e ka edhe anën pozitive gjithmonë duke u bazuar në ato lidhjet që kanë mes veti sikurse që kanë edhe komuniteti shumicë që kanë një gjendje më të mirë ekonomike sociale, mirëpo ne patjetër duhet të mundohemi të gjejmë forma dhe mundësi t'iu ndihmojmë komunitetit jo shumicë qoftë në ndërtimi por edhe atyre që kanë nevojë sepse ata duhet ta sigurojnë një siguri sepse siguria e identiteti i njeriut dhe vetëbesimi që jeton një shoqëri normale që e gëzon edhe një mbështetje

nga shumica është një pasqyrë reale kur komunitetet jo shumicë ta ndjejnë vetën shumë të lirshëm andaj në kuadër të kësaj ne si Komunë jemi munduar që në bazë të mundësive tona buxhetore t’iu ndihmojmë qoftë në sektorin e shëndetësisë, aspektit social dhe të gjitha projektet që janë të mundshme që në periudhat e ardhshme t’iu ndihmojmë atyre që të jenë në një gjendje reale ekonomike duke i’u qëndruar në krah të tyre, unë kështu e kam perceptuar dhe kështu mendoj, megjithatë ky dokument ende është në debat publik dhe mund të pësoj ndryshime.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, sërish falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri-shef i ZKKK për sqarimet dhe paraqitjen e këtij dokumenti. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë ju lus të deklaroheni me ngritje dore se a mbështetni këtë draft plan kështu siç është.

Njëzëri nga anëtarët e Komitetit për Komunitete mbështetet draft plani përkatës sipas materialit të dërguar, i cili pas përfundimit të të gjitha proceduarve do të sjellët sërish si dokument final për shqyrtim dhe miratim final në Kuvendin e Komunës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë kam një ftesë për një takim për anëtarët e Komiteteve për Komunitete nesër dhe pasnesër në një trajnim në “Villa Gërmia” në Prishtinë.

Ftesat i kam me vete dhe do t’jua shpërndaj tani, andaj ata që kanë kohë të marrin pjesë mund të deklarohen tani sepse na duhet që t’i lajmërojmë për numrin e anëtarëve që do të marrin pjesë por edhe për faktin që na duhet të bëjmë kërkesë për një veturë sepse disa prej neve nuk kemi mundësi të shkojmë, prandaj të deklarohen tani ata që do të marrin pjesë, ose nëse ju duhet kohë për menduar mund të më kontaktoni gjatë ditës.

Trajnimi është i mirë dhe na ndihmon shumë në ushtrimin e këtij funksioni, me theks anëtarët e komuniteteve jo shumicë është obligative pothuajse të marrin pjesë.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.prot.01-060/04-0037646/23

Podujevë, 31 maj 2023

Kryesuesi i Komitetit

Xhafer Ademi